



Republika e Kosovës / Republic of Kosovo  
Komuna - Municipality  
Hani i Elezit



01/Nr. 1400/2024  
Data: 20.02.2024

### PROCESVERBAL I KUVENDIT TË KOMUNËS

Procesverbali nga mbledhja e parë -I- e Kuvendit të Komunës, mbajtur me datë 30.01.2023 me fillim pune në ora 11:00 në sallën e Kuvendit të Komunës. Të pranishëm ishin: **Mehmet Ballazhi** (Kryetar i Komunës), **Majlinda Kaloshi** (Drejtoreshë për Zhvillim Ekonomik dhe Turizëm), **Lindita Ballazhi** (Drejtoresh për Buxhet dhe Financa), **Arsim Dernjani** (Drejtor për Shërbime Publike dhe Emergjencë), **Nexhmedin Daci** (Drejtor për Urbanizëm Kadastër dhe Mbrojtje të Mjedisit), **Kimete Kuka -Hasallari** (Drejtoreshë për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale), **Natyra Kalisi** (Drejtoresh e Administratës), **Abduraman Bushi** (Drejtor për Bujqësi, Pylltari dhe Zhvillim Rural), **Hisni Luri** (Drejtor për Arsime, Kulturë, Rini dhe Sport), **Arbenita Bajramaliu** (Drejtoresh për Kulturë, Rini dhe Sport), **Sara Berisha** (Asistente e Kryesuesit të Kuvendit të Komunës), **Visar Hasallari** (Përfaqësues nga Kallzo.com), Kryesuesi pasi konstatoi prezencën e anëtarëve të kuvendit, konstatoi se nuk mungon asnjë anëtarë i Kuvendit të Komunës.

### RENDI I PUNËS

1. Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar.
2. Raporti financiar për vitin 2023.
3. Propozim vendimi për ndarjen e bursave për studentë për vitin akademik 2023-2024.
4. Plani i punës së Këshillave të Fshatrave për vitin 2024.
5. Kërkesë për shfuqizimin e Planit të Integritetit me numër protokoli 01/6387/2022.
6. Kodit i Etikës dhe Mirësjelljes – Komuna Hani i Elezit.
7. Diskutim rreth raportit të auditorit social.
8. Informatë mbi veprimtaritë e subjekteve afariste për vitin 2023.
9. Të ndryshme.

**Kryesuesi** thekson:-për pikat e rendit të punës hapi diskutimin, nëse nuk ka e hedh në votim, rezultati i votimit ishte njëzëri.

U MIRATUA RENDI I PUNËS

## 1. Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar.

**Kryesuesi** thekson:- a keni ndonjë vërejtje rreth procesverbalit, nëse nuk ka e hedh në votim; rezultati i votimit ishte njëzëri.

### U MIRATUAR PROCESVERBALI NGA MBLEDHJA E KALUAR

## 2. Raporti financiar për vitin 2023.

**Kryesuesi** thekson:- për këtë pikë të rendit të punës hapi diskutimin.

**Lindita Ballazhi** thekson:- Buxheti i komunës së Hanit të Elezit i ndarë sipas Ligjit me nr. 08/L-193 mbi ndarjet buxhetore të Republikës së Kosovës për vitin 2023 është në lartësi prej 3,349,715.00 €. Ndërsa buxheti përfundimtarë është 4,252,808.11€, ku në këtë shumë përfshihen: 1. Bartja e të hyrave vetanake të pa shpenzuara të vitit 2021 dhe 2022 në vlerë prej 125,257.43 €, 2. Donacion prej Qeverisë Japoneze për projektin “Ndërtimi aneksit për këmbësor në urën e Seçishtës” në vlerë prej 43,809.40 €, 3. Mjete të mbetura nga Grante të cilat janë bartur vit pas viti në vlerë prej 3,014.43 €. 4. Shtesë nga Qeveria për kategorinë Paga dhe Shtesa si rrjedhojë e hyrjes në fuqi të Ligjit të Pagave 08/L-196. 5. Pranimi i Donacionit nga Unioni Evropian për projektin dy vjeçar “A smart system for Early Floods Detection and Waste Monitoring in the Lepenc River Basin” në shumë prej 446,352.85 €. Nisur nga vlerësimi i përgjithshëm del se niveli i shpenzimit të buxhetit për këtë periudhë janar - dhjetor 2023 është në shumë prej 3,453,882.26 €. Shpenzimi i kategorisë buxhetore Paga dhe Shtesa për vitin 2023 është në shumë prej 1,987,398.32 € apo 96.22%. Shpenzimi i kategorisë buxhetore Mallra dhe Shërbime për vitin 2023 është në shumë prej 472,647.31 € apo 98.97 %. Shpenzimi i kategorisë buxhetore Shpenzime komunale për vitin 2023 është në shumë prej 88,797.56 € apo 92.02 %. Shpenzimi i kategorisë buxhetore Subvencione dhe Transfere për vitin 2023 është në shumë prej 86,955.42 € apo 96.31 %. Shpenzimi i kategorisë buxhetore Shpenzime Kapitale për vitin 2023 është në shumë prej 818,083.65 € apo 61.42 %. Të hyrat totale për vitin 2023 janë në shumë prej 421,872.82 €. Dua ta sqarojë pranimin e donacionit nga Unioni Evropian për projektin dy vjeçar “A smart system for Early Floods Detection and Waste Monitoring in the Lepenc River Basin” në shumë prej 446,352.85 € është bërë më datë 13.12.2023 dhe është regjistruar si e hyrë, ndërkohë që alokimi i të njëjtit është bërë më 12.01.2024. Raporti i kontrollit buxhetor për periudhën janar-dhjetor 2023 ka ndryshuar mbas alokimit të donacionit nga raportet paraprake të kontrollit buxhetor për periudhën janar-dhjetor 2023 të gjeneruar përpara alokimit të donacionit. Në raport i keni të gjitha shënimet në mënyrë të detajuar.

**Zaim Bela** thekson:- u prezantuan të hyrat vetanake, mirëpo në tabelën të cilën e kam unë para vetës shënon se të hyrat vetanake janë në shumë 404,227.82 €, a është kjo shifër e saktë . Sa është shuma e borxhit totalë për vitin 2023 që është bartur në vitin 2024.

**Lindita Ballazhi** thekson:- deri para një jave nuk kemi qenë të barazuar me thesarin e Kosovës dhe nuk kemi pasur as raport mbi të hyrat indirekte, të gjobave të trafikut dhe të agjensionit pyjorë të Kosovës për tre mujorin e fundit të vitit. Shumën që ju e potencuat është pa gjobat indirekte , ndërsa me pranimin e këtyre shumave e kam përditësuar raportin dhe e kam përcjellë. Obligimet e pa paguara janë në shumë prej 18,215.70 €, obligimet kontraktuale të pa paguara janë në shumë prej 414,229.88 €.

**Resul Suma** thekson:- në raport financiarë shënon që shpenzimet kapitale janë shpenzuar deri në 85 % dhe me pranimin e donacionit a i bien që kjo përqindje ka rënë dhe nuk mundemi me mbërriri grandin e donacionit të performancës. Kërkoj sqarim për pagesën e konsulentit të drejtoria për zhvillim ekonomik dhe turizëm.

**Lindita Ballazhi** thekson:- në muajin dhjetorë nëse i marrim fondet të cilat i kemi pasur në dispozicion buxhetin e alokuar në kategorinë për investime kapitale përqindja ka qenë 85 % , mirëpo me datë 13 dhjetorë është transferuar donacioni nga Unioni Evropian dhe është dashur që atë donacion ta regjistrojmë si të hyrë dhe në momentin që e kemi regjistruar si të hyrë nuk ka figuruar në raportet e nxjerrura nga sistemi pastaj në muajin janar e kemi alokuar këtë donacion një pjesë e këtyre mjeteve kanë shkuar në kategorinë e pagave dhe pjesa tjetër është dedikuar në kategorinë e investimeve kapitale. Me alokimin e këtij donacioni kur i kemi alokuar mjete prej sistemit kjo pjesë si e hyrë vetëm që është pranuar në fund të dhjetorit si e hyrë figuron në vitin 2023. Me alokimin në kategorinë e investimeve kapitale normalisht që do të bien përqindja por në atë kohë është e pa mundur me zhvilluar asnjë procedurë të prokurimit për arsye se rregullorja i parasheh afatet kohore për shpenzim të mjeteve dhe për zotim të mjeteve financiare .

**Majlinda Kaloshi** thekson:- shërbimet konsulente janë kur komuna nuk ka kapacitete të mjaftueshme për me ofruar një shërbim e që në rastin tonë e kemi angazhuar konsulentin për fundet IPA për aplikimet dhe komunikimet të cilat i kemi pasur me bashkëpunëtorët tanë që i kemi me Maqedoninë e Veriut dhe me Unionin Evropian.

**Hyriete Isufi** thekson:- ku dedikohen mjetet të cilat janë dërguar në fund të muajit dhjetorë dhe janë regjistruar në muajin janar.

**Lindita Ballazhi** thekson:- donacioni është pranuar me datë 13 dhjetorë dhe është bërë transfero prej Unionit Evropian në llogari të Komunës. Në momentin që janë në donacion ne e regjistrojmë si të hyrë dhe alkimi i këtij donacioni është bërë me 12 janar dhe në momentin që e kemi alokuar nëpër kategori përkatëse buxhetore në bazë të projektit të hartuar, një pjesë ka shkuar në kategorinë e pagave dhe pjesa tjetër në kategorinë e investimeve kapitale.

**Sherif Berisha** thekson:- ne kemi punuar me një raport tjetër dhe gjatë kësaj kohe na janë përcjell edhe dy materiale , kërkoj sqarim për çështjen e përcjelljes së materialit. Kërkoj sqarim për kategoritë e shpenzimeve sepse në gjitha kategoritë ka më shumë shpenzime më shumë se sa në vitin 2022. Te mallrat dhe shërbimet dhe te çështja e derivateve.

**Refet Kalisi** thekson:- për te çerdhja bëhet fjalë për furnizim dhe pije e jo dreka zyrtare a ka mundësi me u ndarë prej shërbimeve të bifejës.

**Lindita Ballazhi** thekson:-në mbledhje të KPF-së e kam dhënë sqarimin që ne nuk kemi qenë të barazuar me thesar dhe nuk e kemi pasur raportin e TM4 e të hyrave indirekte që nuk është faji i komunës sepse është prej Ministrisë se këto raporte i marrim nga divizioni i të hyrave prej Ministrisë por afatin e kemi pasur për me dorëzuar materialin për Kuvend dhe e kam përcjell në këtë mënyrë po e kam njoftuar Kryesuesin . Në momenti që e kam pranuar këtë raport prej thesarit, e kam përditësuar raportin dhe e kam përcjell. Kjo është shkak se pse janë përcjell tre materiale të ndryshme. Shpenzimet në mallra dhe shërbime nëse krahasohen me vitin 2022 janë shpenzuar më shuam sepse janë bërë furnizime më shumë dhe rritja e çmimeve ka ndikuar më shumë dhe çdo kod ekonomik në mallra dhe shërbime e ka sqarimin e vetë. Karburante për vetura është shuma 18,820.55 € që përfshihen pagesat për derivate për të gjitha automjetet të cilat i posedon komuna. Pagesa për te çerdhja dhe për shërbimet e bifejës kryhen prej këtij kodi ekonomik furnizim me ushqim dhe pije jo dreka zyrtare.

**Kryesuesi** thekson:- a keni edhe ndonjë diskutim për këtë pikë të rendit të punës, nëse nuk ka e kalojmë në pikën e radhës të paraparë sipas agjendës.

### 3. Propozim vendimi për ndarjen e bursave për studentë për vitin akademik 2023-2024.

**Kryesuesi** thekson:- për këtë pikë të rendit të punës hapi diskutimin.

**Hisni Luri** thekson:-mjetet financiare që dedikohen për ndarjen e bursave merren nga kategoria subvencione dhe transfere vlera e të cilave është 20 000 € që do të fitojnë 40 studentë .

**Resul Suma** thekson:- shuma është planifikuar 20 000 € por mundemi me lënë 400 € dhe me i përfshirë 50 studentë .

**Hisni Luri** thekson:- ideja është e mirë por është e paraparë me rregullore dhe për me bërë këtë duhet me ndryshuar rregulloren.

**Ajnure Thaçi** thekson:-mendoj që studentëve të cilët studiojnë në fakultetin e gjuhës Gjermane duhet tu epen bursa për shkak se kemi mungesë , ndërsa kuadër të gjuhës angleze mendoj që kemi mjaftueshëm.

**Hisni Luri** thekson:- sa do që kemi adekuatë neve po na mungon nëpër shkolla. Është e vërtet që më e rëndësishme për momentin është gjuha Gjermane sepse jemi në mungesë.

**Zaim Bela** thekson:- nëse mbesin tre apo katër studentë a ka mundësi me shtuar numrin prej ndonjë far fondin që mos me mbetur anash.

**Hisni Luri** thekson:- nëse mbeten katër apo pesë studentë do shikojmë mundësitë me gjetur mirëkuptim përmes aleancës së bizneseve.

**Kryesuesi** thekson:- a keni edhe ndonjë diskutim për këtë pikë të rendit të punës, nëse nuk ka e hedh në votim; rezultati i votimit ishte njëzëri.

U MIRATUA PROPOZIM VENDIMI PËR NDARJEN E BURSAVE PËR STUDENTË PËR VITIN AKADEMIK 2023-2024

### 4. Plani i punës së Këshillave të Fshatrave për vitin 2024.

**Kryesuesi** thekson:- për këtë pikë të rendit të punës hapi diskutimin.

**Natyra Kalisi** thekson:- plani është hartuar në bazë të rregullores për bashkëpunim me këshillat e fshatrave dhe vendbanimet urbane.

**Sherif Berisha** thekson:- është mirë që ekzekutivi ti shikon mundësitë buxhetore për me ua kompensuar mëditjet për shkak se nuk po kanë vullnet për me punuar.

**Natyra Kalisi** thekson:- jemi për me u a kompensuar por duhet t'i shikojmë bazën ligjore.

**Refet Kalisi** thekson:- a janë funksionalë katër këshillat apo na mungon ndonjë.

**Natyra Kalisi** thekson:-dorëheqje me shkrim nuk kam prej asnjërit kryetarë të këshillave të fshatrave.

**Kryesuesi** thekson:- a keni edhe ndonjë diskutim për këtë pikë të rendit të punës, nëse nuk ka e hedh në votim; rezultati i votimit ishte njëzëri.

U MIRATUA PLNI I PUNËS SË KËSHILLAVE TË FSHATRAVE PËR VITIN 2024

## 5. Kërkesë për shfuqizimin e Planit të Integritetit me numër protokoli 01/6387/2022.

**Kryesuesi** thekson:- për këtë pikë të rendit të punës hapi diskutimin.

**Natyra Kalisi** thekson:- me ardhjen e një vendimit të agjencisë së antikorrupsionit , kemi propozuar që plani duhet të shfuqizohet, t'i kalojë në kompetencë kryetarit të komunës.

**Kryesuesi** thekson:- për këtë pikë të rendit të punës hapi diskutimin, nëse nuk ka e hedh në votim; rezultati i votimit ishte njëzëri.

### U MIRATUA KËRKESA PËR SHFUQIZIMIN E PLANIT TË INTEGRITETIT ME NUMËR PROTOKOLI 01/6387/2022

## 6. Kodit i Etikës dhe Mirësjelljes – Komuna Hani i Elezit.

**Kryesuesi** thekson:- për këtë pikë të rendit të punës hapi diskutimin.

**Natyra Kalisi** thekson:- është punuar nga grupi punës për arsye se është miratuar para pesë viteve dhe është ristrukturuar në harmoni me dispozitat ligjore

**Refet Kalisi** thekson:- a përfshihet veshja në këtë kod .

**Natyra Kalisi** thekson:- neni shtatë i parasheh rregullat sa i përket veshjes.

**Kryesuesi** thekson:- a keni edhe ndonjë diskutim për këtë pikë të rendit të punës, nëse nuk ka e hedh në votim; rezultati i votimit ishte njëzëri.

### U MIRATUA KODI I ETIKËS DHE MIRËSJELLJES –KOMUNA HANI I ELEZI

## 7. Diskutim rreth raportit të auditorit social.

**Kryesuesi** thekson:- për këtë pikë të rendit të punës hapi diskutimin.

**Mehmet Ballazhi** thekson:- është hera e parë që bëhet auditimi sociale në pesë komuna dhe në secilën komunë nga një projekt në mënyrë që me parë se si janë zhvilluar procedurat e një projekti nga fillimi i procedurave administrative deri te implementimi brenda kësaj se cilat janë kërkesat e qytetarëve dhe sa janë përfshirë kërkesat e qytetarëve brenda një projekti që është planifikuar prej ekzekutivit të komunës. Në komunën tonë është projekti i parkut të qytetit që janë bazuar në disa rekomandime. Brenda raportit janë disa rekomandime që nuk është material akuzë që e shikova me një postim por janë për ta përmirësuar një projekt që mbarëvajtja me qenë e mirë e projektit që nga procedurat administrative deri në fund. Kërkesat brenda një projekti mund të dalin edhe më vonë.

**Sherif Berisha** thekson:- të gjeturat që janë dhënë në raport qëndrojnë duke filluar prej projektit pastaj debate, problemet me çështjen e ujitjes, pjesa shtesë e cila është bërë. Është mirë që të na sqarohen.

**Kryesuesi** thekson:- përfaqësuesit e këtij raporti i kemi prezentë dhe nëse jeni në dakord si asamblistë mund t'u a jap fjalë. Pasi që jeni në dakord si asamblistë, atëherë ftoj të prononcohet rreth këtij raporti z.Visar Hasallari.

**Visar Hasallari** thekson:-në bazë të dokumenteve që i kemi kërkuar nga komuna projekti është hartuar nga një kompani private sepse nga përgjigjet të cilat i kemi marr prej komunës nuk ka burime njerëzore për me bërë një projekt të tillë . Kompania e cila e ka bërë projektin është Alba Grup shpk . Rreth çështjes së tenderit si ka shkuar si proces e kemi monitoruar. Falënderoj menaxherin e kontratës z.Drim Dernjani të cilin e kemi kontaktuar për çdo rast që kemi hasur dhe është munduar të na shpjegojë de të njëjtën kohë dhe znjsh. Liridona Ballazhi. Jemi takuar me Kryetarin e Komunës dhe gjithë punën e kemi bërë vullnetare për

me bërë një punë të mirë për komunitetin. Pjesë e këtij grupi është familja e të ndjerit "Isa Berisha" që kanë dhënë një rol të rëndësishëm dhe idetë e tyre se si ata e shohin pjesën e ardhshme të asaj hapësire. Ata mendojnë që një pjesë me lënë si arkiv që përmes disa fitove që ne kemi mundur mi gjet që një pjesë e bunkerëve me shërbyer për vizitorët e ardhshëm. Një pjesë e rekomandimeve që i kemi dhënë është që komunë dhe kryetarin ta mbajmë si një lloj pengu për të mirë .

**Mehmet Ballazhi** thekson:- ne e kemi ofruar bashkëpunimin e domosdoshëm që e kemi pasur me Birnin si përfaqësues apo udhëheqës të auditimit social dhe kemi dashur që ky projekt me dal më mirë se na që e kemi planifikuar. Projektimi është bërë prej kapaciteteve tona dhe si projekt është hartuar por është dashur patjetër me pasur një kompani të licencuar. Pjesën e rekomandimeve që unë jam zotuar që kemi me i implementuar ato që mundemi me i implementuar. Bunkerët nuk janë funksional për shkak të mundësive buxhetore por nëse në të ardhmen shpreh interesim dikush mund të zhvillohet ndonjë biznes i kafiterisë nëse dikush donë me investuar ne jemi të gatshëm me ja lejuar. Njërin bunker tjetër kemi planifikuar që të jetë si lloj muzeu i qytetit që di hynë edhe pjesa e familjes "Isa Berisha" qoftë me fotografi apo relikte tjera që kanë mbetur prej kohës së atëhershmit . Sa i përket ujit që kërkohet të vendoset një qeshëm, ne jemi të vetëdijshëm që duhet por për shkak se nuk ka ujë të pishëm për momentin, ndërsa përmes shpimit nuk mundemi sepse është i pa pishëm uji. Çështja e tualeteve është problem me u bërë për shkak se mirëmbajtja është problem. Rekomandimet të cilat janë dhënë besoj që kanë me u implemetuar duke u bazuar në mundësit buxhetore që i kemi.

**Sherif Berisha** thekson:- edhe më herët i kam pasur vërejtjet për Murseli kompani edhe pse e dimë që nuk mundemi me ndaluar por e njëjta kompani edhe në pushtetin e kaluar edhe tash e njëjta kompani thuaj se gjitha tenderët që janë i merr.

**Mehmet Ballazhi** thekson:-janë kriteret që paraqiten kur shpallet një tender dhe është zyra e prokurimit e cila i udhëheqë këto procedura dhe përgjegjësia bien mbi ta vlerësimi që bëhet. Unë nuk mundem me ja ndaluar askujt për me aplikuar për me ofertuar. Së bashku me ekipin kemi pasur vërejtje që janë duke u ngadalësuar punët dhe sy arsye e ka pasur për shkak të kushteve atmosferike. Është vonuar realizimi i projektit por është kryer. Procedurat e tenderimit dhe ofertimit është çështje ligjore dhe kompania që përmendët nuk i ka marr gjitha tenderët dhe ata që i plotësojnë kriteret munden me marr tenderin dhe kompanitë tjera e kanë të drejtën e ankesës në OSHP.

**Sherif Berisha** thekson:- për afatet të cilat kanë skaduar a ka ndërmarr drejtori ndonjë dënim për arsye të vonesave.

**Nexhmedin Daci** thekson:- sa i përket vonesave kryesisht kanë qenë të arsyeshme sepse ka pasur reshje shumë të mëdha të shiut dhe në këto rrethana kompania nuk ka mundur me punuar. Nuk dua me mbrojt kompaninë për shkak se nuk varet prej kryetarit apo prej ndonjë anëtari të bordit të drejtorëve se kush i merr tenderët por janë procedurat e prokurimit dhe ka ligj për ato punë por vonesat më të vërtetë i ka pasur të arsyeshme. Kemi pasur vonesa në shpalljen e tenderit për realizimin e projektit të parkut për shkak të problemeve buxhetore sepse nuk i kemi pasur mjetet financiare në fillim të vitit të ndara, një pjesë ka qenë e grantit që janë transferuar në muajin Gusht dhe fakti që janë vonuar punimet nuk e kanë bërë parkun më të keq ose më të mirë që do të thotë se nuk është ndonjë element që negativisht ka ndikuar. U potencua që e njëjta kompani i ka marr gjitha tenderët por vitin e kaluar e ka pasur vetëm fazën e dytë të parkut dhe nuk ka pasur asnjë tender tjetër.

**Kryesuesi** thekson:- a keni edhe ndonjë diskutim për këtë pikë të rendit të punës, nëse nuk ka kalojmë në pikën e radhës të paraparë sipas agjendës.

## 8. Informatë mbi veprimtarit e subjekteve afariste për vitin 2023.

**Kryesuesi** thekson:- për këtë pikë të rendit të punës hapi diskutimin.

**Majlinda Kaloshi** thekson:- në këtë informatë përfshihen të hyrat të cilat drejtoria i ka inkasuar në vitin 2023 , faturimin dhe statistikën e tjera. Të regjistruara janë 357 biznese e që prej tyre 50 biznese janë pasive. Te sektori i taksave inkasimi ka qenë 9.7 % .

**Zaim Bela** thekson:- a përfshihet edhe pagesa e kompanisë “Sharrcem” . Sa është shuma e borxheve që e kanë kompanitë ndaj komunës.

**Majlinda Kaloshi** thekson:- faturimi është në shumë prej 97 159.74 €, ndërsa inkasimi është në shumë prej 77,857.44 €, ndërsa sa i përket borxheve vlerë të saktë nuk kam por mundem me ua përcjell me shkrim.

**Kryesuesi** thekson:- për këtë pikë të rendit të punës hapi diskutimin, nëse nuk ka kalojmë në pikën e radhës të paraparë sipas agjendës.

## 6. Të ndryshme.

**Kryesuesi** thekson:- për këtë pikë të rendit të punës hapi diskutimin.

**Resul Suma** thekson:- ka filluar faturimi i ujit në Han të Elezit dhe drejtoria për shërbime publike a është në kontakt me kompaninë Bifurkacioni sepse ka shtëpia që në Han të Elezit ju kanë faturuar 250 kubik ujë gjë që unë mendoj se nuk është në rregull . Ka edhe shumë persona të cilët janë ankuar për shkak se faturimi ose ka ndodhë gabimisht ose diçka nuk është në rregull me orëmatësit. Faturimi është tu ndodhë por ujë nuk është tu pasur .

**Mehmet Ballazhi** thekson:- çështja e ujit është diskutuar në çdo mbledhje dhe konstatimi që s'ka ujë ne jemi për ditë në terën, konstatimi që ka mungesë të ujit jemi për ditë në teren , konstatimi që ka probleme jemi për ditë në kontakt dhe këto janë çështje të thata . Problemi për zgjidhjen e çështje së ujit po mundohemi qe dy vite me bërë zgjidhje dhe nëse i japim na një solucion të mbylljes së fabrikës hajdeni shkojmë dhe e mbyllim por a është zgjidhje kjo nuk është zgjidhje por ne po bëjmë përpjekje maksimale për me zgjidhur problemi dhe jemi në proces. E fundit që ka qenë ja kemi dorëzuar kompanisë Bifurkacioni këtë aset që është e përcaktuar me ligj dhe e detyruar që me mirëmbajtur, me u përgjigjur për të gjitha këto probleme që dalin. Te çështja e faturimit mund të ketë probleme dhe ende nuk i kam parë faturat dhe nëse dikujt i ka ardhur që ka shpenzuar 250 kubik mund të ketë ndonjë gabim teknik dhe me faturën e parë nuk mundesh me konstatuar se është një problem i pa zgjidhur në momentin që do të vijën ne e bëjmë kalkulimin dhe nuk e them unë prej vetës këtë por prej të tjerëve që kanë më shumë se unë eksperiencë për çështjen e ujërave. Nëse fabrika prodhon 17 litra në sekondë i bien diku 11300 banorë mund të përfitojnë me 150 litra ujë në ditë për person dhe a i kemi ne 11300 banorë por mund të jenë 3000 , mund të jenë 3500 apo maksimumin e kemi bërë 5000 që i bien në 5000 banorë 310 litra që do të thotë që 310 litra është mbi nevojat e qytetarëve ditore që i kanë. Nëse 17 litra në sekondë po prodhohen dhe po paguhen 7 litra në sekondë atëherë me automatizëm e dimë që 10 litra në sekondë po humben . Nëse humbin 10 litra duhet ta shikojmë a po keqpërdoren apo ka ndonjë zbrazje diku. Kalkulimet duhet të bëhen jo brenda një fature dy tri deri sa të vjen faza e ujëmatësve kolektiv pra këto janë procese që do të ndodhin dhe nuk mundemi shpejtë me marr një veprim. Jemi në proces dhe është edhe një problem i mos pranimit të vendosjes së ujëmatësve te disa personave dhe kjo është fazë dhe nuk mundemi dhunshëm me i detyruar por duhet të gjejmë format.

**Erbli Meliqi** thekson:- u diskutua edhe më herët çështja e administratorit të Hanit të Elezit dhe unë jam takuar rastësisht me atë dhe më njoftoj se ishte në Gjermani por është mirë me zgjedhë një administratorë tjetër për shkak se nuk mundet nga Gjermania mi zgjidh problemet e qytetarëve. E kemi diskutuar çështjen për shportat e mbeturinave sepse qyteti ka mungesë po ashtu edhe në zonat rurale kanë mungesë dhe është mirë që brenda viti 2024 me zgjidhur. Disa banorë janë të interesuar me shpall pronën e tyre publike për me shtruar rrugën me kupëza betoni dhe me vendosë ndriçim.

**Natyr Kalisi** thekson:- janë procedurat ligjore që e përcaktojnë momentin e largimit apo shkarkimit. Është udhëzimi administrativ i cili i përcakton procedurat se si me vepruar. Edhe më herët e potencova që shkresë zyrtare nuk kemi pranuar.

**Sherif Berisha** thekson:-nëpër shkolla ka mungesë të projektorëve dhe mund të zëvendësohen apo të riparohen. Në projekte janë kupëza në toka private , a do të ndryshoni qasje me menduar diçka tjetër dhe pse po shtrohen në prona private.

**Nexhmedin Daci** thekson:- ku do që kemi shtruar rrugë kemi marr pëlqime prej pronarëve të tokave. Sa i përket interesimit për me i shtruar rrugët është mirë që në dëgjimet buxhetore me i dhënë propozimet qytetarët.

**Hisni Luri** thekson:- projektorët mungojnë te shkolla fillore “Ilaz Thaçi” por kemi menduar me bërë një zgjidhje por duhet ta kemi parasysh që nuk e kemi buxhetin e alokuar dhe në momentin që alokohet buxheti kemi me bërë një zgjidhje permanente, mirëpo jemi duke pritur që infrastrukturën me najë rregulluar prej donacionit prej ministrisë të cilën e kemi pasur dhe fazën e parë e kanë bërë testimin për me shtri infrastrukturën e rrjetit me fibra optike. Te projektorët jemi për me bërë një zgjidhje momentale për ndryshe jemi për me i larguar dhe me i pajisur me televizorë të mençur apo me tabela të mençura.

**Refet Kalisi** thekson:- është realitet që të gjithë e dimë sepse kemi shtuar rrugë private dhe pëlqimet i kemi marr por edhe unë sa isha drejtor pëlqimet i kam marr por nuk janë bartur dhe atë problem e kemi. Është mirë me u interesuar dhe me i bartur për shkak se janë rrugë që janë shtruar para dhjetë viteve e nuk janë bartur. Te çerdhja propozoj që nxemja të bëhet me pompë termike.

**Hyrijete Isufi** thekson:- burimeve të ujit a ju bëhen analizat për shkak se po mbushin ujë të pishëm dhe është mirë me ju bërë që secili e dinë pastaj se cili burim është i pishëm. Propozoj që të vendosën dollap për llaptopë për shkak se nuk kanë implementim buxhetorë. U diskutua çështja e parkut dhe u potencua vetëdijesimi por unë mendoj që shkon shumë ngadalë është mirë që me i shfrytëzuar kamerat dhe me shqiptuar dënime

**Arsim Dernjani** thekson:- analizat janë bërë më herët dhe burimi i ujit në fshatin Dimcë dhe në Paldenicë sipas analizave që janë bërë është pishëm . Sa i përket shportave të mbeturinave qe një vit jemi duke pritur donacionin prej Gizit por konkret nuk kemi diçka dhe besoj që kemi me i rregulluar.

**Hisni Luri** thekson:- secila shkollë i ka mjetet financiare për mallra dhe shërbime dhe nëse drejtorët e shohin të arsyeshme që janë të nevojshëm ne mundmi me aprovuar kërkesën e tyre. Çështjen e nxemjes me pompë termike do t'i shikojmë mundësit buxhetore për me bërë.

**Mehmet Ballazhi** thekson:- është rregullorja e shkollës që munden profesorët me ua konfiskuar telefonat dhe nëse bëhen dollapët dhe nëse nuk ua marrinë ata përsëri kanë me i përdorë.

**Hanumshahe Dibrani** thekson:- shumë drita të ndriçimit publik nuk janë në funksion. Zebrat te Ura e Seçishtës duhet të bëhen.

**Arsim Dernjani** thekson:- sa i përket ndiçmit publik jemi duke pritur me u alokuar buxheti për shkak se kontrata ka përfunduar dhe do ta shpallim tenderin për ndriçimin publik. Zebrat do të kryhen.



**Zaim Bela** thekson:- problem kemi me çështje të rrymës për shkak se nëse një erë e vogël fryn po mbesim pa rrymë. Është mirë që përmes administratorëve me bërë petitionit dhe me dorëzuar në Ferizaj dhe është mirë drejtoria e Shërbimeve Publike me u angazhuar për këtë çështje. Te kanali i hapur pse janë bërë ato hekurat .

**Resul Suma** thekson:- vitin 2022 dhe 2023 drejtoria e urbanizmit i ka shtruar disa rrugica me kubëza betoni por një rrugicë në Lagjen Brava është mirë me rregulluar dhe me ju vendosur ndriçimi publik .

**Nexhmedin Daci** thekson:- te ajo rrugicë ka pas kanal dhe normalisht që flenë dhe do të rregullohet në këtë vit .

**Malik Berisha** thekson:- për çështjen e rrugës së Gorancës a keni ndonjë informacion.

**Mehmet Ballazhi** thekson:- kemi bërë përpjekje për këtë çështje, ju kemi drejtuar me shkrim me shkresa dhe kërkesa por edhe në takime që kemi pasur e kemi paraqitur si problem . Kjo është çështje Ministrisë dhe deri më tani nuk kemi diçka konkrete.

**Kryesuesi** thekson:- a keni edhe ndonjë diskutim për këtë pikë të rendit të punës, nëse nuk ka shpalli të mbyllur mbledhjen.

Ju faleminderit për pjesëmarrje.

Mbledhja përfundoi në ora 13:24.

Procesmbajtësi  
Ayni Bushi

